



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1164/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “TALI”SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-20-5015-5-2-1 dhe nr. te brendshëm: GL-651-20-058-521, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN, më datën: 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-20-5015-5-2-1 dhe nr. te brendshëm: GL-651-20-058-521, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-20-5015-5-2-1 dhe nr. te brendshëm: GL-651-20-058-521, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 28.12.2020 me nr. 1164/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit” me nr. të prokurimit: 651-20-5015-5-2-1 dhe nr. te brendshëm: GL-651-20-058-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 par.1 dhe 2, 6 par.1, 7 par.1, 2 dhe 4, 56 par 1.1 dhe 1.2 dhe par 3, 59 par 4, 60 par 1 nën par 1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nenin 4.4 , 26, 41 pika 3 RRUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 11.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së)

- Sa i përket **Pretendimit Nr. 1** të Grup i Operatorëve Ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk se padrejtësisht është eliminuar për shkak udhëheqësi i punishtes z. Valon Latifi si Bachelor i Ndërtimtarisë nuk i k katër vite përvojë profesionale pas diplomimit.

Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që AK pa te drejtë e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues, i cili ka ofertuar me çmimin me te lirë.

AK – Komuna e Gjilanit ne Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosje te tenderit, kriterin e ka përshkruar ne mënyrë jo te kjohtë "Udhëheqës i punishtes Inxhinier ose bachelor i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, ose infrastrukturë rrugore me se paku katër (1) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)."

Ne këtë rast kur numri (1) është i vendosur ne parantezë qe e definojnë kuptimin e tekstit te shënuar para numrit. Forma si është shënuar ky kriter nga AK, ka krijuar paqartësi tek OE ofertues dhe mundësi qe ata te bien në lajthitje, për çka OE nuk janë fajtor për këtë gjë dhe nuk mund te dëmtohen për gabimet e AK. Ne rastin konkret AK - Komuna e Gjilanit, duke marrë parasysh se kriterin e ka shënuar ne mënyrë jo te drejtë, është dashtë qe ne përputhje te Nenit 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese nga OE ankues, nëse ky operator disponon me ndonjë inxhinier tjetër shtesë te këtij profili dhe me eksperience me te madhe për ta plotësuar kriterin e tenderit.

Oferta e OE te rekomanduar është rreth 400% me e shtrenjte se sa oferta e OE ankues.

- Sa i përket Pretendimit Nr. 2 të Grup i Operatorëve Ekonomik "AVAG GROUP & EING COM" shpk se i është vonuar qasja ne dokumentacion nga ana e AK – Komuna e Gjilanit.

Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi që AK me datën 08.12.2020 e ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde, ndërsa OE ankues ka kërkuar qasje ne dokumentacion me datën 13.12.2020 d.m.th. pas pesë ditësh dhe ne ditën e fundit te ankimimit, andaj rrezikun për mundësinë e kalimit te afatit ankimor e ka merre vete OE ankues qe nuk ka kërkuar qasje me herët. Por duke marre parasysh se dita kurë OE ankues ka kërkuar qasje ne dokumentacion, me datën 13.12.2020 ka qene ditë e hënë pas vikendit, AK është dashtë ta ketë parasysh këtë gjë dhe mos ta vonoj OE për qasjen e kërkuar, duke ja rrezikuar te drejtën për ankesë.

Përveç pretendimeve ankimore, vlen te theksohet se AK ne Dosjen e tenderit, është dashtë ta përshkruaj ne mënyrë te drejtë kriterin e dhënies se kontratës: Çmimi me i lirë me Poentim, ndërsa e ka përshkruar:

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët
--------------------	------	---

Konstatim: Konsideroj që Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, te sigurojnë qe fondet publike te shfrytëzohen në mënyrë efikase, duke pasur parasysh që OE ankues ka ofertën me te lirë nga te gjitha ofertat, si dhe rreth 400% me lirë se sa oferta e OE te rekomanduar për kontratë. Duke marre parasysh rëndësinë e projektit dhe nevojën për mirëmbajtje dimërore te rrugëve ne periudhën e dimrit, AK duhet te arrije ti tejkaloj defektet e shkaktuara ne fazën e tenderimit me qellim te kontraktimit sa me te shpejtë te projektit.

Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore të Grup i Operatorëve Ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk ndaj Njoftimit mbi Vendimin e AK dhe arsyes se eliminimit janë të bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues: Grup i Operatorëve Ekonomik “AVAG GROUP & EING COM” shpk të pranohet si e bazuar, rrjedhimisht të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK dhe ky Aktivitet i prokurimit të kthehet në **RIVLERËSIM**.

Autoriteti kontraktues me datë 14.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuyk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Duke pasur parasysh gjendjen atmosferike që është duke mbizotëruar në vendin tone andaj, kerkojm nga Paneli Shqyrtes –OSHP, që në një afat sa më afert kohor të caktohet seanca kryesore dhe të njoftohet AK-me vendimin e Panelit Shqyrtues.

Operatori ekonomik me datë 15.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me rivlerësim me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket pretendimit të grupit të OE “AVAG GROUP & EING COM” shpk, se padrejtësisht është eliminuar për shkak udhëheqësi i punishtes z. Valon Latifi si Bachelor i Ndërtimtarisë nuk i ka katër vite përvojë profesionale pas diplomimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është i bazuar, pasi që AK pa të drejtë e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues, i cili ka ofertuar me çmimin më të lirë. AK në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, kriterin e ka përshkruar në mënyrë jo të qartë “Udhëheqës i punishtes Inxhinier ose bachelor i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, ose infrastrukturë rrugore me se paku katër (1) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit)”. Në këtë

rast kur numri (1) është i vendosur në parantezë që e definon kuptimin e tekstit të shënuar para numrit. Forma si është shënuar ky kriter nga AK, ka krijuar paqartësi tek OE ofertues dhe mundësi që ata të bien në lajthitje, për çka OE nuk janë fajtor për këtë gjë dhe nuk mund të dëmtohen për gabimet e AK. Ne rastin konkret AK - Komuna e Gjilanit, duke marrë parasysh se kriterin e ka shënuar në mënyrë jo të drejtë, është dashtë që në përputhje të nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues, nëse ky operator disponon me ndonjë inxhinier tjetër shtesë të këtij profili dhe me eksperiencë më të madhe për ta plotësuar kriterin e tenderit. Oferta e OE të rekomanduar është rreth 400% më e shtrenjte se sa oferta e OE ankues.

Sa i përket pretendimit tjetër të grupit të OE “AVAG GROUP & EING COM” shpk, se i është vonuar qasja në dokumentacion nga ana e AK – Komuna e Gjilanit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron që ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi që AK me datë 08.12.2020 e ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK dhe Letrat Standarde, ndërsa OE ankues ka kërkuar qasje në dokumentacion me datën 13.12.2020 d.m.th. pas pesë ditësh dhe në ditën e fundit të ankimimit, andaj rrezikun për mundësinë e kalimit të afatit ankimor e ka marrë vetë OE ankues që nuk ka kërkuar qasje më herët. Por duke marrë parasysh se dita kur OE ankues ka kërkuar qasje në dokumentacion, me datën 13.12.2020 ka qenë ditë e hënë pas vikendit, AK është dashtë ta ketë parasysh këtë gjë dhe mos ta vonoj OE për qasjen e kërkuar, duke ja rrezikuar të drejtën për ankesë.

Përveç pretendimeve ankimore, duhet të theksohet se AK në Dosjen e tenderit është dashtë ta përshkruaj në mënyrë të drejtë kriterin e dhënies së kontratës: Çmimi me i lirë me Poentim, ndërsa e ka përshkruar:

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
--------------------	------	--

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, duke mos u siguruar që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efikase, duke pasur parasysh që OE ankues ka ofertën më të lirë nga të gjitha ofertat, si dhe rreth 400% më e lirë se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Po ashtu, Paneli Shqyrtues vlerëson se duke pasur parasysh rëndësinë e projektit dhe nevojën për mirëmbajtje dimërore të rrugëve në periudhën e dimrit, AK duhet të arrij ti tejkaloj defektet e shkaktuara në fazën e tenderimit me qëllim të kontraktimit sa më të shpejtë të projektit. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë nëse është e nevojshme konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-

së, si dhe të bëjë vlerësim, ekzaminim dhe krahasim të tenderëve në bazë të kritereve të vendosura nga AK dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK GJILAN";

1x1 OE "AVAG GROUP & EING COM" shpk;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.